

L I G J
Nr.8227, datë 30.7.1997

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8215, DATË 9.5.1997 "PËR
KONTROLLIN FINANCIAR TË PERSONAVE JURIDIKË JOBANKARË, QË KANË
MARRË HUA NGA PUBLIKU I GJERË"**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e një grupi deputetësh,

**KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.8215, datë 9.5.1997 "Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë", paragrafi i parë i nenit 1 ndryshohet si vijon:

"Këshilli i Ministrave cakton një ose më shumë ekspertë kontabël të pavarur ose një shoqëri të kualifikuar në këtë drejtim dhe me besueshmëri, të cilët do të jenë ekspertë të personit fizik a juridik, si dhe të personave të lidhur me ta. Pagesa e ekspertëve kontabël miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Ekspertët kontabël duhet t'i paraqesin administratorit raportin dhe rezultatin e kontrollit për gjendjen financiare të personit që do të kontrollohet apo të personave të lidhur me të, si dhe një kopje të tyre t'ia dërgojnë Këshillit të Ministrave."

Neni 2

Paragrafi i dytë i nenit 1 të ligjit bëhet paragrafi i tretë.

Neni 3

Paragrafi i dytë i nenit 7 të ligjit nr.8215, datë 9.5.1997 "Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë", shfuqizohet.

Pas paragrafit të tretë të nenit 7 shtohet paragrafi katërt me këtë përmbajtje:

"Për aq kohë sa ndaj subjektit të kontrollit apo personit të lidhur me të nuk ka mbaruar kontrolli dhe administrimi sipas këtij ligji, organet gjyqësore dhe ato të prokurorisë nuk fillojnë proceset gjyqësore apo hetimore."

Neni 4

Pas nenit 7 të ligjit shtohet neni 7/1 me këtë përmbajtje:

"Ky ligj zbatohet për gjithë ata individë, persona fizikë a juridikë, që më poshtë do të quhen "subjekte kontrolli", të cilët kanë marrë hua apo marrin hua nga publiku ose në mënyra të tjera mbledhin para nga publiku, me përjashtim:

- të një banke të licencuar nga Banka e Shqipërisë në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- të një shoqërie, e cila emeton letra me vlerë për investime në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- të një personi fizik, i cili merr hua në përputhje me parashikimet e Kodit Civil, por që të plotësohen njëkohësisht të tri kushtet e mëposhtme:
 - a. huamarrja të mos jetë vazhdimsi e veprimtarisë së tij;
 - b. huaja të përdoret për qëllime personale;
 - c. interesi i dhënë si pasojë e huasë të mos jetë më i lartë se 10 për qind mbi normat e interesit vjetor të caktuara nga Banka e Shqipërisë për depozitat respektive në momentin e lidhjes së kontratës së huamarrjes.

Në kuptim të këtij ligji, një person i lidhur me subjektin e kontrollit nënkupton çdo person juridik a fizik, që më poshtë do të quhet "person i lidhur", nëse

- ai është i lidhur në mënyrë direkte ose indirekte me drejtimin e subjektit të kontrollit ose
- kur subjekti i kontrollit në mënyrë direkte apo indirekte kontrollon personin e lidhur, ose
- kur personi i lidhur në mënyrë direkte a indirekte zotëron të paktën 20 për qind të aksioneve apo pjesëve të kapitalit, ose të një interesi pronësor të subjektit të kontrollit, ose
- kur subjekti i kontrollit zotëron në mënyrë direkte a indirekte të paktën 20 për qind të aksioneve apo pjesë të kapitalit ose të një interesi pasuror të personit të lidhur, ose
- kur personi i lidhur ka marrë në forma të ndryshme direkte a indirekte mjete financiare nga subjekti i kontrollit."

Neni 5

Pas nenit 7/1 të ligjit shtohet neni 7/2 me këtë përmbajtje:

"Këshilli i Ministrave cakton me vendime subjektet e kontrollit ose personat e lidhur me ta, që i nështrohen dispozitave të këtij ligji, si dhe administratorët në subjektet e kontrollit ose personat e lidhur me ta. Si administrator caktohen persona fizikë a juridikë, si dhe shoqëri të kualifikuara dhe me besueshmëri, vendase ose të huaja. Kur për të njëjtin subjekt të kontrollit caktohen më shumë se një administrator, ata i ushtrojnë kompetencat e tyre së bashku.

Administratorët caktohen nëse plotësohet të paktën një nga kushtet vijuese:

- a. Subjekti i kontrollit është në gjendjen e paaftësisë paguese, ose nëse verifikohet se rrezikohet për t'u ndodhur në gjendjen e paaftësisë paguese;
- b. subjekti i kontrollit ka pezulluar, ose është gati të pezullojë pagesat, apo nuk ka mundësi të shlyejë detyrimet e tij në momentin që ato duhet të përmbushen sipas akteve të lidhura prej tij me persona të tretë;
- c. veprimtaria e subjektit të kontrollit është në kundërshtim me parimet dhe rregullat e njohura financiare;
- d. gjendja në të cilën ndodhet subjekti i kontrollit është në kundërshtim me parimet dhe rregullat e njohura financiare;
- e. është në interes publik që subjekti i kontrollit ose personat e lidhur me ta të jenë subjekte të këtij ligji për shkak se kanë tërhequr në favor të tyre pasuri të personave të tretë.

Kur Këshilli i Ministrave merr një vendim në bazë të paragrafit të dytë të këtij neni, personi i prekur prej tij ka të drejtë që brenda pesë ditëve të publikimit të këtij vendimi të bëjë ankim në gjykatën e apelit duke argumentuar dhe kërkuar që ky vendim është marrë në kundërshtim me këtë ligj. Në rast se në gjykatën e apelit paraqitet ankimi, administratori do të vazhdojë të kryejë veprimtarinë e tij gjatë gjithë periudhës së shqyrtimit të ankimit nga ana e kësaj gjykate.

Brenda 10 ditëve nga data e paraqitjes së ankimit, gjykata e apelit e shqyrton atë dhe vendos refuzimin ose pranimin e tij. Në rastin e pranimit të ankimit, gjykata e apelit urdhëron Këshillin e Ministrave të ndërpresë administrimin. Dhënia e një vendimi për ndërprerjen e administrimit nuk ka efekte për vlefshmërinë e veprimeve të kryera nga administratori përpara datës së marrjes dijeni për këtë vendim. Dhënia e një vendimi përfundimtar nga ana e gjykatës së apelit nuk përjashton të drejtën e Këshillit të Ministrave që, kur vëren se plotësohen kushtet e këtij ligji, të nxjerr një vendim tjetër për caktimin e administratorit për subjektet e kontrollit ose për personat e lidhur me ta.

Administratori, brenda tre ditëve nga data e caktimit të tij duhet:

- a. të vendosë, në çdo zyrë a lokal ku zhvillon veprimtarinë subjekti i kontrollit, një lajmërim, me anë të të cilit të njoftojë ndërmarrjen e këtij veprimi dhe të specifikojë emrin e subjektit të kontrollit, si dhe emrin e administratorit;
- b. të botojë një lajmërim me të njëjtat efekte, të paktën në një gazetë me qarkullim kombëtar.

Administratori, brenda tre ditëve nga marrja në kontroll të personit të lidhur, duhet të botojë një lajmërim, në të cilin duhet të jetë i specifikuar emri i personit të lidhur dhe emri i administratorit. Lajmi duhet të botohet të paktën në një gazetë me qarkullim kombëtar."

Neni 6

Pas nenit 7/2 të ligjit shtohet neni 7/3 me këtë përmbajtje:

"Nëse një subjekt i kontrollit ose person i lidhur me të është subjekti i administrimit sipas këtij ligji, nuk do të kryhet pa autorizimin paraprak të administratorit asnjë nga veprimet e mëposhtme:

a. Të fillojë ose të vazhdojë një procedurë gjyqësore a procedura të tjera kundër vetë subjektit të kontrollit apo personave të lidhura me të;

b. të ndërmarrë masa për të zbatuar vendimet gjyqësore në lidhje me subjektin e kontrollit apo të personave të lidhur me të;

c. të ushtrojë ndonjë kompetencë a të drejtë në lidhje me masa sigurimi të pasurisë së subjektit të kontrollit apo të personave të lidhur me të;

d. të kërkojnë të marrin në zotërim pasuritë në emër të subjektit të kontrollit dhe të personit të lidhur me të;

e. të lidhin kontrata qiraje ose të ushtrojnë të drejta lidhur me kontratat e qirave të lidhura mbi pasuritë e subjektit të kontrollit apo të personit të lidhur me të;

f. të ushtrojnë të drejtën e zëvendësimit të pretendimeve kreditore dhe debitoare, kur ato janë të ndërsjella me njëra-tjetrën ose kundër subjekteve të kontrollit ose të personave të lidhur me ta.

Parashikimet e paragrafit të parë të këtij neni nuk kufizojnë të drejtën e asnjë personi të kërkojë të ushtrojë të drejtat e tij në lidhje me kontrata apo detyrime të marra përsipër pas datës së caktimit të administratorit tek subjekti i kontrollit apo person i lidhur me të.

Asnjë person nuk ka të drejtë të transferojë tek të tretët brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, pa lejen e administratorit, pasuri apo detyrime të subjektit të kontrollit ose të personit të lidhur me të."

Neni 7

Pas nenit 7/3 të ligjit shtohet neni 7/4 me këtë përmbajtje:

"Administratori i subjektit të kontrollit ose i personit të lidhur me të ka të drejtë të vendosë për të mos zbatuar kushtet e parashikuara në ndonjë kontratë apo marrëveshje të lidhur, para datës së caktimit të administratorit, ndërmjet subjektit të kontrollit apo personit të lidhur me të dhe personave të tretë, të pezullojë tërësisht apo pjesërisht ripagimin e ndonjë huaje apo pagimin e një detyrimi.

Drejtimi i veprimtarisë dhe i pasurisë së subjekteve të kontrollit apo të personave të lidhur me ta i kalon administratorit. I gjithë personeli drejtues i subjekteve të kontrollit apo të personave të lidhur me ta nuk kanë të drejtë të ushtrojnë të drejtat e tyre për drejtimin e veprimtarisë apo të marrin veprime lidhur me pasuritë e subjektit të kontrollit apo të personave të lidhur me të, me përjashtim të rasteve kur një e drejtë e tillë u njihet nga administratori në përputhje me kushtet e përcaktuara prej tij.

Administratori i subjektit të kontrollit, ose i personave të lidhur me të, ushtron të gjithë të drejtat e aksionerit, ortakut, si dhe personelit administrativ të tyre. Ai ka të drejtë:

a. të realizojë veprimtarinë e subjektit të kontrollit apo të personave të lidhur me të;

b. të administrojë pasurinë e tyre në mënyrën që ai e konsideron të nevojshme;

c. të caktojë apo kontraktojë këshilltarë profesionistë, si dhe agjentë brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;

d. të ndalojë subjektin e kontrollit apo personin e lidhur me të të marrë hua, ose të mobilizojë mjete monetare nga publiku.

Administratori i subjektit të kontrollit apo i personave të lidhur me të ka të drejtë të shesë a të disponojë në mënyrë ligjore pjesë të veprimtarisë së personave të mësipërm apo pjesë të pasurisë së tyre në kushtet që ai e konsideron të arsyeshme. Në rast se ndonjë pasuri e subjektit të kontrollit apo e personave të lidhur me të është vendosur si masë garancie prej tyre, një gjë e tillë nuk e pengon administratorin të realizojë të gjitha procedurat e shitjes apo të përdorimit të tyre. Përfituesi i masës së sigurimit mund të paguhet nga procedurat e shitjes apo të administrimit të këtyre pasurive me prioritet në krahasim me kreditorët e tjerë, me përjashtim të kostos së administrimit gjatë shitjes apo përdorimit të këtyre pasurive. Përfituesi i masës së sigurisë e fiton këtë të drejtë vetëm nëse administratori mendon se kjo masë për sigurimin e një veprimi është vënë në mënyrë të vlefshme për të siguruar një veprim të pastër ose mbrojtjen e një detyrimi pa mashtrim në favor të përfituesit."

Neni 8

Pas nenit 7/4 të ligjit shtohet neni 7/5 me këtë përmbajtje:

"Në rastet kur administratori vëren se një pasuri e subjektit të kontrollit apo të personave të lidhur me të është përdorur ose u është tjetërsuar të tretëve në mënyrë të parregullt apo në kundërshtim me ligjin, ai lajmëron personin përfitues dhe i kërkon atij kthimin e kësaj pasurie në favor të administratorit, ose të kërkojë pagimin e shumave ekuivalente në rast se ajo pasuri nuk gjendet më, ose nuk mund të kthehet përsëri në natyrë, siç ishte në momentin e tjetërsimit.

Çdo person i prekur nga paragrafi i parë i këtij neni lidhur me pronësinë, ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatë në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për këtë çështje."

Neni 9

Pas nenit 7/5 të ligjit shtohet neni 7/6 me këtë përmbajtje:

"Shpenzimet e kryera nga administratori për realizimin e detyrave në përputhje me këtë ligj shlyhen nga ana e administratorit me prioritet ndaj detyrimeve të tjera që kanë subjektet e kontrollit apo personat e lidhur me ta.

Shteti mund t'i japë administratorit shumat e miratuara paraprakisht nga Këshilli i Ministrave për koston, shpenzimet dhe detyrimet e tjera të bëra prej administratorit gjatë ushtrimit të detyrës së tij.

Tarifat për administratorët miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave."

Neni 10

Pas nenit 7/6 të ligjit shtohet neni 7/7 me këtë përmbajtje:

"Shumat e parave të evidencuara dhe të mbledhura nga administratori gjatë ushtrimit të detyrës së tij në përputhje me këtë ligj, paguhen pasi të jenë shlyer prioritetet e parashikuara në këtë ligj, sipas një skeme të veçantë shpërndarjeje, e cila duhet të miratohet me ligj."

Neni 11

Pas nenit 7/7 të ligjit shtohet neni 7/8 me këtë përmbajtje:

"Këshilli i Ministrave ka të drejtë të shkarkojë administratorin e subjektit të kontrollit apo të personit të lidhur me të nga detyra, kur ai bëhet fizikisht apo mendërisht i paaftë për të realizuar detyrën e tij, ose kur falimenton apo kur ai ka shkelur kompetencat dhe të drejtat që ai ka gjatë ushtrimit të detyrës së tij.

Administratori i një subjekti të kontrollit apo një personi të lidhur me të ka të drejtë të japë dorëheqjen në mënyrë të motivuar, duke ia paraqitur atë Këshillit të Ministrave.

Kur administratori shkarkohet nga detyra ose largohet vetë në përputhje me parashikimet e paragrafit të parë dhe të dytë të këtij neni, ose kur ai vdes, Këshilli i Ministrave ka të drejtë të caktojë administrator tjetër në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

Kur Këshilli i Ministrave verifikon se:

- a. të gjitha detyrimet janë paguar, ose
- b. vazhdimësia e veprimtarisë së subjektit të kontrollit apo e personave të lidhur me të nuk justifikon koston e administrimit për vazhdimësinë e mundësisë për gjetjen e pasurive të tjera, mundet, duke lajmëruar me shkrim administratorin e subjektit të kontrolluar apo të personit të lidhur me të, të përfundojë administrimin në ditën e parashikuar në lajmërim."

Neni 12

Pas nenit 7/8 të ligjit shtohet neni 7/9 me këtë përmbajtje:

"Administratorët do të rimbursohen nga shteti për çdo detyrim, duke përfshirë edhe shpenzimet gjyqësore, të cilat vijnë si rezultat i zbatimit të kompetencave të tij sipas dispozitave të këtij ligji. Në rastet e moszbatimit të kompetencave sipas dispozitave të këtij ligji për faj të administratorit, bëhet rimbursim nga shteti."

Neni 13

Pas nenit 7/9 të ligjit shtohet neni 7/10 me këtë përmbajtje:

"Të gjithë ata persona, të cilët zotërojnë libra kontabël, të dhëna, dokumente apo pasuri, të cilat i takojnë subjektit të kontrollit apo të personave të lidhur me të, duhet menjëherë pas caktimit të administratorit të tyre, t'i dorëzojnë ato me ose pa kërkesë të administratorit.

Administratori i subjektit të kontrollit apo i personit të lidhur me të mund t'i kërkojë çdo personi t'i japë informacion që ka të bëjë me ushtrimin e veprimtarisë së administratorit, duke përfshirë këtu edhe informacionet për shkëmbimet valutore të tij, ose me sekretin e mbajtjes së parave jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Në këtë rast dispozitat e parashikuara nga ligji nr.8075, datë 22.2.1996 "Për sistemin bankar në Republikën e Shqipërisë" dhe çdo dispozitë tjetër ligjore në lidhje me ruajtjen e këtij sekreti nuk zbatohen."

Neni 14

Pas nenit 7/10 të ligjit shtohet neni 7/11 me këtë përmbajtje:

"Në kuptin të nenit 235 të Kodit Penal konsiderohet pengim i veprimtarisë së administratorit mosplotësimi i kërkesave të tij të përcaktuara nga ky ligj, si dhe mosplotësimi i kërkesave që pengojnë transferimin apo disponimin e pasurisë nga ana e administratorit".

Neni 15

Pas nenit 7/11 të ligjit shtohet neni 7/12 me këtë përmbajtje:

"Administratori i subjektit të kontrollit apo i personave të lidhur me të duhet të paraqesë pranë Këshillit të Ministrave, brenda afateve të caktuara prej tij, raporte mbi ecurinë e punës për ushtrimin e të drejtave dhe kompetencave të caktuara nga ky ligj".

Neni 16

Ky ligj hyn në fuqi më datën 30 korrik 1997.

Shpallur me dekreten nr.1861, datë 31.8.1997 të Presidentit të Republikës të Shqipërisë, Rexhep Meidani